



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 85/17 Prot.

Tiranë, më 19.07.2016

V E N D I M

Nr. 80, datë 19.07.2016

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 85/4., datë 19.04.2016”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, referuar nenit 185, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procesin e inspektimit, zhvilluar në institucionin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve,

VËREJ SE:

Pas marrjes dijeni për qëndrimin e mbajtur nga drejtuesi i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve në cilësinë e eprorit direkt, dhe Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me mospërfundimin e procedurës së konfirmimit si nëpunës civil të punonjësit *****, i cili mban pozicionin “Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore”, pranë këtij inspektorati, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka kryer verifikimin paraprak të rastit duke kërkuar prej Departamentit të Administratës Publike si njësi përgjegjëse, nëpërmjet shkresës nr. 85/1 prot., datë 02.03.2016, shpjegimin e qëndrimit të mbajtur dhe kopje të dokumentacionit përkatës.

Me shkresën nr. 85/2 prot., datë 31.03.2016, Departamenti i Administratës Publike, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se është mbajtur ai qëndrim për shkak se pozicioni i punës “Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore”, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, në nivel qendror, bazuar në nenin 2, germa “h”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, dhe ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, nuk

mund të trajtohet si pjesë të shërbimit civil, për shkak se sipas ligjit, inspektorët e pyjeve lejohen të mbajnë armë e për këtë arsye procesi i konfirmimit është lënë pa përfunduar.

Pas përfundimit të verifikimit paraprak, dhe analizës së materialit të mbledhur dhe zbërthimit të natyrës së detyrave konkrete që përmban dhe kryen ky pozicion pune si dhe vendit që ai zë në skemën e hierarkisë administrative, linden dyshime të arsyeshme se në këtë rast kemi të bëjmë me cenim të të drejtave të nëpunësit civil që garantohen nga legjislacioni për shërbimin civil, e për këtë arsye, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me aktin administrativ nr. 85/4., datë 19.04.2016, urdhëroi fillimin e verifikimit në tërësi të ligjshmërisë të këtij rasti.

Në përfundim të procesit të inspektimit, projektrelacioni me rezultatet e hetimit administrativ iu dërgua për njohje subjektit të inspektuar, me shkresën nr. 58/12 prot., datë 17.05.2016, *“Dërgohet projektrelacioni “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 85/4, datë 19.04.2016”*, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin.

Po kështu projektrelacioni iu dërgua edhe Ministrisë së Mjedisit, në cilësinë e institucionit që e ka në varësi, me shkresën nr. 85/14 prot., datë 17.05.2016, *“Dërgohet projektrelacioni “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 85/4, datë 19.04.2016”* dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse me shkresën nr. 85/13 prot., datë 17.05.2016, *“Dërgohet projektrelacioni “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 85/4, datë 19.04.2016”*.

Pas kësaj, projektrelacioni është kthyer nga titullari i institucionit, me shkresën nr. 3262/1 prot., datë 27.05.2016, *“Opservacion mbi projektrelacionin”*. Nga përmbajtja e kësaj shkrese, rezulton se subjekti i inspektuar kërkon marrjen në konsideratë të disa pretendimeve, për të cilat Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me kërkesat e parashtruara në Observacionin në fjalë, ka dhënë përgjigjen ligjore, e cila është përfshirë në këtë vendim.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Nga aktet e administruara ka rezultuar se, nëpunësi ***** ka filluar marrëdhënien e punës pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, në nivel qendror, me Urdhrin nr. 461, datë 21.02.2014, të Ministrit të Mjedisit, në pozicionin *“Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore”*, pa respektuar procedurat e konkurimit, që parashikoheshin prej ligjit nr. 8549 dt. 11.11.1999 *“Statusi i nëpunësit civil”*, që ishte në fuqi në atë kohë.

Pavarësisht këtij fakti, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*, të Këshillit të Ministrave, duke qenë se ky punonjës ishte i punësuar në këtë vend pune, për një periudhë më pak se një vit, atëherë njësia përgjegjëse (DAP), me aktin nr. 3301/11, datë 30.10.2014, me të drejtë, ka deklaruar statusin e tij të punësimit, si pjesë e shërbimit civil, në pozicionin *“Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore”*, si

nëpunës civil në periudhë prove. Periudha e provës i ka filluar nga data e fillimit të efekteve të ligjit, 26.02.2014.

Gjatë kësaj periudhe, provohet se nëpunësi ka plotësuar kërkesat e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) me 22 pikë. Në të njëjtën kohë, është vlerësuar në nivelin “shumë mirë”, (nota 1), në vlerësimet e ndërmjetme të rezultateve individuale në punë, nga ana e eprorit të tij, në periudhat, nga 21.02.2014 deri 31.12.2014, dhe 01.01.2015 deri 30.06.2015.

Në përfundim të periudhës 1 vjeçare të provës, rezulton se titullari i institucionit, në cilësinë e eprorit direkt, nuk e ka nxjerrë aktin administrativ për konfirmimin e punonjësit në fjalë, si nëpunës civil, me pretendimin se pozicioni i punës “Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore”, me ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil”, (nëpërmjet ligjit nr. 178/2014) nuk mund të jetë më pjesë e shërbimit civil, për shkak se inspektorët e pyjeve janë punonjës të cilëve u lejohet të mbajnë armë.

Nuk provohet që të ketë një akt administrativ konkret që të ketë shprehur këtë qëndrim të titullarit të institucionit, në momentin e përmbushjes së periudhës së provës, por për herë të parë e gjejmë të artikuluar në shkresën nr. 201/2 prot., datë 03.03.2016, që ai i ka drejtuar Departamentit të Administratës Publike, ku ka parashtruar si argument se në pikën 10, të nenit 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Inspektori i Policisë Pyjore është punonjësi me arsimin përkatës pyjor, me uniformë, i armatosur ...” dhe ka vijuar argumentin, duke e bazuar në pretendimin se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në nenin 2, të ligjit, u shtua germa “h”, në të cilën parashikohet se, nuk mund të bëjnë pjesë në shërbimin civil, punonjësit, të cilët ushtrojnë një funksion publik e që sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë.

Në mbështetje të këtyre dispozitave, titullari i institucionit arrin në përfundimin se pozicioni i punës “Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore”, duke qenë se në skemën e hierarkisë administrative, ai është eprori direkt i inspektorëve të Policisë Pyjore, dhe meqë vartësit e tij, sipas ligjit lejohet të mbajnë armë, atëherë për rrjedhojë edhe ai si drejtues i tyre, mund të mbajë armë, ç’ka e pengon atë të jetë pjesë e shërbimit civil.

Të njëjtin argument ka përdorur edhe Departamenti i Administratës Publike, i cili, ndonëse nuk i ka kthyer përgjigje direkte institucionit në fjalë, e ka materializuar qëndrimin e tij, në shkresën nr. 85/2 prot., datë 31.03.2016, “Kthim përgjigje”, drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ku është shprehur se: “...pozicionet e punës brenda Drejtorisë së Inspektoratit të policisë Pyjore, nuk janë më pjesë e shërbimit civil, pasi punonjësit në këto pozicione, bazuar në ligjin nr. 9385 dt. 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore dhe sipas ligjit mbajnë armë”.

Duke e analizuar qëndrimin e institucionit dhe të Departamentit të Administratës Publike në përmbajtjen e tij, si dhe duke e krahasuar me rregullimet ligjore të fushës së veprimit të institucionit, sipas dispozitave përkatëse në këtë rast, rezulton se:

Në momentin e shqyrtimit të këtij rasti, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, funksionon në bazë të Vendimit nr. 46, datë 29.01.2014, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”, i ndryshuar, (me Vendimin nr. 103, datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”).

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, në përbërje të të cilit është edhe Drejtoria e Inspektoratit të Policisë Pyjore, është trajtuar si institucion vartësie, pjesë e shërbimit civil dhe në bazë të nenit 67, të këtij ligji, punonjësit e institucionit në fjalë kanë fituar statusin e punësimit në shërbimin civil.

Ashtu si është trajtuar më sipër, nga ana e institucionit dhe Departamentit të Administratës Publike, pretendohet se, pozicionet e punës të Drejtorisë së Policisë Pyjore, e cila në momentin e ndryshimeve ligjore kishte në strukturë, **1** Drejtor dhe **6** Inspektorë të Policisë Pyjore, (sipas strukturës miratuar me Urdhrin nr. 148, datë 17.04.2014, të Kryeministrit, pasi aktualisht, me urdhrin nr. 37, datë 12.03.2015, të Kryeministrit, kjo drejtori është riorganizuar), nuk mund të jenë pjesë e shërbimit civil.

Nisur nga ky përfundim i arritur prej këtyre institucioneve, u analizuan funksionet dhe detyrat konkrete, të pozicionit të punës “Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore” dhe funksioneve të tjera me natyrë drejtuese dhe organizuese, sipas Vendimit nr. 46, datë 29.01.2014, të Këshillit të Ministrave dhe formularit të përshkrimit të punës të këtyre pozicioneve dhe në veçanti të pozicionit të punës që është bërë shkak për këtë inspektim, i cili ka ndryshuar në datën 17.03.2014 dhe është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit. Në përfundim të kësaj analize, rezulton se, ky pozicion përmban funksione dhe kryen detyra krejt të ndryshme nga ato që kryejnë inspektorët e Policisë Pyjore.

Pozicioni në fjalë, paraqitet si njësi e specializuar e shërbimit pyjor, me attribute drejtuese, menaxhuese organizative, monitoruese dhe gjykuese të pavarur, që merret me formulimin dhe zbatimin e politikave, zbatimin e rregullave dhe procedurave administrative, ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e këtyre politikave, karakteristika këto që përkojnë me përmbajtjen e dispozitës që përkufizon kategorinë e nëpunësit civil dhe konkretisht të germës “c”, të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Përveç sa argumentit më sipër, Drejtori i Inspektoratit të Policisë Pyjore, në bazë të pikës 8, Kreu III “Mënyra e organizimit dhe funksionimit të ISHMP-së”, të Vendimit nr. 46, datë 29.01.2014, të Këshillit të Ministrave, për shkak të funksionit, është anëtar i Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve. Ky komision, sipas pikës 8.1, e në vazhdim, të aktit nënligjor të mësipërm, është organi që shqyrton ankimet administrative kundër vendimeve përfundimtare të inspektimit dhe funksionon në përputhje me procedurat e ankimeve, të parashikuara ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me Kodin e Procedurave Administrative të RSH.

Ky funksion me karakter gjykimi, nuk ka pësuar ndryshim edhe pas miratimit të Vendimit nr. 103, datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave, që është aktualisht në fuqi. Në pikën 7, Kreu

II “Misioni dhe funksionet e ISHMP-së”, të këtij akti nënligjor, thuhet shprehimisht se pozicioni i punës “Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore”, për shkak të detyrës, është anëtar i Komisionit të Ankimit të ISHMP-së.

Në nenin 51, pika 2, të Kreut VI, “Ankimi ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit”, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjvënësi ka përcaktuar shprehimisht se: “Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm “Organi epror”, sipas Kodit të Procedurave Administrative, është një njësi apo trupë kolegjiale ankimi, e krijuar brenda inspektoratit shtetëror, organit të varësisë pjesë e të cilit është inspektorati shtetëror, apo njësisë vendore përkatëse dhe që ka në përbërje, nëpunës të pavarur, nga ata të përfshirë në marrjen e vendimit të ankimuar”

Në kuptim kësaj dispozite, Komisioni i Ankesave është një trupë kolegjiale për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të inspektorëve pyjorë, e krijuar brenda Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve. Anëtarët e këtij Komisioni, të cilët kanë kompetenca për vlerësimin e ligjshmërisë të veprimeve administrative të inspektorëve pyjorë, dhe kjo në mënyrë të natyrshme të çon në përfundimin se ata janë nëpunës të cilët kanë funksion të ndryshëm nga Inspektorët e Policisë Pyjore dhe Inspektorët e Mjedisit. Fakti që Drejtori i Inspektoratit të Policisë Pyjore, është në përbërje të organit që shqyrton ligjshmërinë e vendimeve përfundimtare të inspektimit, që merren nga inspektorët e pyjeve, apo të mjedisit, tregon pikërisht veçorinë që mbart ky funksion, nga natyra ekzekutive e funksionit të inspektorëve.

Për më tepër, funksioni i Drejtorit të Inspektoratit të Policisë Pyjore në nivel qendror, dallohet nga funksioni i inspektorëve edhe për faktin se inspektorët e pyjeve, janë punonjës të pajisur me licencë të posaçme dhe të regjistruar në listën e Inspektorëve të Inspektimit Pyjor, në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror, www.inspektoratiqendror.gov.al dhe pas regjistrimit në këtë listë, në bazë të nenit 2, pika 10, të ligjit nr. 9385 dt. 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, lejohet që ata të pajisen me armë. Ndërkohë, nga verifikimi i kryer, rezulton se Drejtori i Policisë Pyjore, nuk figuron në këtë listë, nuk ka licencë inspektori dhe nuk përfshihet në detyrimin për tu pajisur me armë.

Nga ana tjetër, në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: “punonjësi i policisë (pa specifikuar i cilës polici) është nëpunës civil dhe ndaj tij zbatohet ky ligj, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm”. Duke e aplikuar këtë dispozitë në rastin konkret, arrihet në përfundimin se, Drejtori i Inspektoratit të Policisë Pyjore, është punonjës i Inspektoratit të Policisë Pyjore, por në ligjin e posaçëm nuk parashikohet detyrimi/lejimi për pajisjen me armë, gjë e cila në bazë të nenit 2, pika “h” të ligjit në fjalë, do të përbënte pengesë për trajtimin e tij si nëpunës civil.

Pretendimi i parashtruar në observacion, se pozicioni i punës “Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore” dhe inspektorët e policisë pyjore, janë subjekte që lejohet të mbajnë armë dhe si të tillë nuk mund të jenë pjesë e shërbimit civil, nuk është i drejtë.

Siç është thënë edhe më lart, pika 10, e nenit 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht që: “Inspektori i Policisë Pyjore është punonjës i arsimit përkatës pyjor, me uniformë, i armatosur, i pajisur me kartë identifikimi ...”. Për më tepër, inspektorët e policisë pyjore pajisen me licencë të posaçme për kryerjen e

detyrës dhe regjistrohen në listën zyrtare, e cila bëhet publike duke u shpallur në faqen zyrtare të institucionit.

Pra, ligji material, përcakton në mënyrë të shprehur se, janë “inspektorët e policisë pyjore” subjektet që lejohet të mbajnë armë dhe nëse mungon kjo cilësi, pra, cilësia e të qenit “inspektor”, nuk mund të detyrohesh të mbash armë.

Parashtrimet dhe arsyetimi i mësipërm, duhej të përbënin në fakt atë proces pune që duhej të kryente njësia e personelit dhe Departamenti i Administratës Publike, në momentin e lindjes së situatës së re, që krijoi ndryshimi i nenit 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Ndryshimi i dispozitës së sipërpërmendur, në vetvete krijoi premisa për të vënë në diskutim ekzistencën, ose jo, të statusit të nëpunësit civil, për atë kategori nëpunësish që, sipas saj, bënin pjesë në kategorinë e punonjësve që lejohet të pajisen me armë.

Në momentin që filloi funksionimi i dispozitës së mësipërme dhe nëpunësit për këtë shkak prekeshin prej saj në statusin e punësit, organit kompetent, njësisë së personelit, i ka lindur detyrimi për trajtimin e tyre sipas institutit të liritimit nga shërbimi civil, në këtë rast parashikuar prej pikës 1, germa “dh”, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Sipas pikës 4, të dispozitës së mësipërme, lirimi duhej të ishte deklaruar me vendim të arsyetuar të njësisë së burimeve njerëzore, e cila nga ana e saj, brenda 3 ditëve kishte detyrimin të njoftonte DAP-in. Ky i fundit, në bazë të pikës 47, të Kreut VII, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i cili ishte në fuqi në momentin e krijimit të kësaj situatë, brenda një afati 5 ditor, kishte detyrimin të dëgjonte palët dhe të shqyrtonte problemin dhe kishte të drejtë të pranonte ankesën dhe ta kthente procedurën për rishqyrtim, pranë njësisë për burimet njerëzore të institucionit përkatës.

Pra, siç shihet, legjislacioni i shërbimit civil ka parashikuar një sërë rregullash e procedurash të hollësishme, për trajtimin e rasteve të liritimit nga shërbimi civil, me qëllim garantimin e të drejtave të nëpunësit dhe sigurimin e të drejtës së tij të mbrojtjes, për të evituar mundësinë e veprimeve e qëndrimeve arbitrare nga ana e organeve kompetente shtetërore.

Mosrespektimi i këtyre procedurave, si nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ashtu dhe nga Departamenti i Administratës Publike, ka bërë që problemi, nëse nëpunësit e nivelit drejtues-menaxherial, të Drejtorisë së Policisë Pyjore në nivel qendror, bëjnë pjesë ose jo në shërbimin civil, ka mbetur i pazgjidhur dhe aktualisht, disa nëpunës të institucionit, (duke përfshirë edhe drejtuesin e ISHMP-së) janë nëpunës civilë, e për disa të tjerë, pa të drejtë, mbahet një qëndrim me standard të ndryshëm, duke pretenduar se nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Ky mosrespektim i procedurës, ka sjellë si pasojë që, nëpunësve të mos u jepet mundësia e mbrojtjes institucionale dhe aktualisht, megjithëse kanë kaluar disa muaj nga momenti i evidentimit të problemit, ai nuk ka gjetur zgjidhje.

Për më tepër, punonjësin ***** , pa respektuar asnjë nga dispozitat që mbrojnë nëpunësin civil, me aktin nr. 340, datë 21.02.2016, në një kohë që ende nuk ishte liruar nga shërbimi civil, pa respektuar procedurat e caktuara nga ligji, e kanë ulur në detyrë, duke e emëruar “Përgjegjës në Sektorin e Analizës së Riskut, Zjarreve dhe Rojeve Pyjore”, në Drejtorinë e Inspektoratit të Policisë Pyjore.

Një moment tjetër që flet për mosrespektim të të drejtave të nëpunësve, e cila vjen kryesisht nga mosrespektimi i afateve të kryerjes së veprimeve administrative sipas ligjit, është edhe fakti që, në rastin e nëpunësit ***** , apo edhe për nëpunës të tjerë, megjithëse afati një vjeçar i provës, është përfunduar, (afati 1-vjeçar i provës ka përfunduar në datë 26.02.2015) nuk është vepruar nga ana e organizmave përkatëse për të realizuar vlerësimin në fund të periudhës së provës dhe konfirmimin, ose jo, të statusit të nëpunësit civil, duke i hequr në këtë mënyrë nëpunësve, padrejtësisht, mundësinë që ata të përfitojnë nga pasja e këtij statusi, në përputhje me nenin 24, të ligjit për nëpunësin civil, që rregullon në mënyrë të shprehur institutin e periudhës së provës. Ky është një moment tjetër, për të cilin Komisioneri duhet të ndërhyjë për rregullimin e ligjshmërisë.

Shkelja e rregullave të parashikuara nga neni 66, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që bën fjalë për lirimin nga shërbimi civil dhe Kreut VII, të Vendimit nr. 171 datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, bëjnë që, bazuar në nenet 115/a, e 116/c, të ligjit nr. 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, (i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve), tregon që veprimet administrative të kryera deri në këtë moment nga ana e institucioneve përgjegjëse, të konsiderohen si të pamjaftueshme dhe të kryera në kundërshtim me procedurën ligjore, e për këtë arsye ato konsiderohen si veprime juridike absolutisht të pavlefshme, që nuk mund të krijojnë pasoja të ligjshme.

Gjithë argumentet dhe arsyetimi i mësipërm, shërbejnë si shkak i ligjshëm që njësia e personelit të ISHMP-së dhe Departamenti i Administratës Publike, të bëjnë edhe një herë vlerësimin e qëndrimit në lidhje me vijimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, apo lirimin nga shërbimi civil të ankuesit dhe të punonjësve të tjerë të sferës menaxheriale e monitoruese të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve në përgjithësi dhe të Inspektoratit të Policisë Pyjore në veçanti.

Deri në momentin e qëndrimit përfundimtar të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, si dhe të Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me ç`ka u trajtua më sipër, në përputhje me procedurat ligjore që rregullojnë këtë rast, të gjithë punonjësit e këtij institucioni, të cilët gëzojnë të drejtat e nëpunësit civil, për shkak të ligjit, apo te rekrutimit nëpërmjet konkurrimit, kanë mundësi që ti ushtrojnë ato, duke u konsideruar si pjesë e shërbimit civil.

Duke ndjekur arsyetimin e mësipërm, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duhet filluar procedura me deklarinimin prej njësisë përgjegjëse, të statusit të nëpunësit civil, për gjithë ata punonjës që u ka lindur kjo e drejtë për shkak se fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i gjeti në pozicione punë të shërbimit civil, apo janë emëruar me konkurrim, pas fillimit të efekteve të këtij ligji dhe kanë plotësuar periudhën e provës, duke përfshirë këtu edhe rastin në fjalë.

Pas kësaj, në vartësi të qëndrimit përfundimtar, pas rivlerësimit që do të bëhet në mënyrë të argumentuar nga njësia përgjegjëse, në lidhje me raportin e pozicionit të punës me shërbimin civil, për çdo pozicion konkret të institucionit, i cili aktualisht është pjesë e shërbimit civil, pra nëse pozicioni i punës do të mbetet, ose jo, në shërbimin civil, të vijohet procedura ligjore e përcaktuar në nenin 66, pika 1, germa “ë”, e pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 171 datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”.

Në rast se vendimi final do të anojë në favor të përjashtimit të pozicioneve të caktuara të punës, së këtij institucioni nga shërbimi civil dhe punonjësi me vullnetin e tij të lirë vendos të qëndroj në pozicionin e tij të punës, i cili tashmë është jashtë fushës së veprimit të ligjit për nëpunësin civil, atëherë, drejtoria e burimeve njerëzore dhe Departamenti i Administratës Publike, duhet të mbajnë parasysh faktin se, ky rast duhet trajtuar si dorëheqje nga shërbimi civil dhe nëpunësi duhet të përfitojë nga dispozita përkatëse që rregullon këtë institut të ligjit, që është pikërisht neni 64, paragrafi 4 “Dorëheqja”, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kjo dispozitë i jep nëpunësit të drejtën për të konkurruar si nëpunës civil, nëpërmjet lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të këtij ligji, për një periudhë deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

Ky qëndrim i Komisionerit mbështetet në modelin e shërbimit civil, të aplikuar me ligjin aktual për nëpunësin civil, i cili e konsideron statusin e nëpunësit civil si një të drejtë të lidhur me personin që e ka fituar dhe jo me pozicionin e punës që ai mban.

Fakti që pozicioni i punës ka dalë nga shërbimi civil, për shkak të vullnetit të ligjvënësit, nuk mund ta penalizojë nëpunësin civil dhe ta nxjerrë atë nga skema e shërbimit civil, duke mos përfituar asnjë të drejtë në këtë rast.

Kjo për faktin se nuk ndodhemi në kushtet kur përfundimi i marrëdhënies me shërbimin civil ka ndodhur për shkak të veprimeve të kryera me faj prej tij, në kundërshtim me ligjin.

Po kështu, ky moment nuk ka asnjë lidhje me rastet parashikuara në mënyrë specifike në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të cilat bëjnë fjalë për përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil për shkak të ligjit, sipas nenit 65 të këtij ligji. Në këto raste vetëm konstatohet fakti i specifikuar në këtë dispozitë, nga ana e burimeve njerëzore dhe nuk parashikohet asnjë e drejtë për punonjësin që ndodhet në ato rrethana.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, referuar nenit 185, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”; e nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

Nisur nga gjithë sa u analizua më sipër, për rregullimin e ligjshmërisë së rastit të nëpunësit ***** dhe rasteve të tjera të ngjashme, njësia e personelit të ISHPM-së dhe njësia përgjegjëse (*Departamenti i Administratës Publike*) të veprojë si më poshtë:

1. Të merren masat e nevojshme, nga njësia e personelit të institucionit dhe nga njësia përgjegjëse, për të kryer veprimet e nevojshme ligjore për përfundimin e periudhës së provës dhe konfirmimin si nëpunës civil për punonjësin ***** në pozicionin e punës “*Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore*”, duke u bazuar në vlerësimin e rezultateve individuale në punë dhe rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
2. Të merren masat e nevojshme, nga njësia e personelit të institucionit dhe nga njësia përgjegjëse, për të kryer veprimet e nevojshme ligjore për përfundimin e periudhës së provës, edhe në raste të tjera të ngjashme, kur punonjësit janë deklaruar në periudhë prove në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të ri (*neni 67*), apo janë rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit. Në këto raste duhet vepruar duke plotësuar kërkesat e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, (i shfuqizuar, por sipas përcaktimeve të pikës 1, Kreu IX, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, procedurat e periudhës së provës që kanë filluar sipas parashikimeve të vendimit nr. 143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, përfundojnë sipas parashikimeve të këtij vendimi).
3. Nëpunësi ***** të rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës “*Drejtor i Inspektoratit të Policisë Pyjore*”, pasi ulja e tij në detyrë, është kryer në kundërshtim me procedurën ligjore të përcaktuar nga ligji në këtë rast.
4. Njësia përgjegjëse (*DAP*) dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të vlerësojnë situatën e shërbimit civil, në Inspektoratin e Përgjithshëm të Mjedisit dhe Pyjeve, në përgjithësi dhe në Inspektoratin e Policisë Pyjore në veçanti, duke përcaktuar raportin e pozicioneve të punës në këtë institucion, me fushën e shërbimit civil, nëpërmjet vendimeve të arsyetuara për çdo pozicion pune që do të vlerësohet se nuk mund të jetë pjesë e shërbimit civil.

Nëse pozicionet do të rivlerësohen si jashtë fushës së shërbimit civil, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, duhet të respektojë procedurën e përcaktuar në pikën 4, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe në Kreun VII, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”. Në këtë rast, punonjësve duhet t’u krijohet mundësia që të japin pëlqimin ose jo, për të qëndruar në pozicionin e ri të punës, duke u shpallur njëkohësisht, edhe e drejta që u njihet atyre, prej nenit 64, paragrafi 4 “*Dorëheqja*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i

ndryshuar, në rast se vazhdojnë marrëdhënien e punës me pozicionin që del jashtë shërbimit civil, apo në rast se nuk pranojnë që të vijojnë më tej punën në këtë pozicion.

Kjo dispozitë i jep nëpunësit të drejtën për të konkurruar si nëpunës civil, nëpërmjet lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të këtij ligji, për një periudhë deri në 2 vjet, pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

5. Të gjithë nëpunësit civil, të cilët aktualisht gëzojnë statusin e nëpunësit civil, kanë të drejtë të aplikojnë për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe të përfitojnë të gjitha të drejtat e tjera që atyre i njeh ligji për nëpunësin civil.
6. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA